



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**

---

Numri i lëndës: 2021:264423

Datë: 13.03.2024

Numri i dokumentit: 05443304

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Durim BALAJ, me bashkëpunëtoren profesionale Argjelina Prenku, në çështjen juridike të përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditores M.U., nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit i përfaqësojnë Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj avokat në Prishtinë, kundër debitores së përmbarimit Komunës së Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për përmbarimin e dokumentit të ekzekutueshëm – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.1886/21 të datës 13.12.2022, për shkak të kompensimit e ushqimit në punë si dhe të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në shumën e përgjithshme prej 730.00 euro, duke vendosur për debitimin e mjeteve përmes xhirollogarisë bankare, jashtë seancës gjyqësore, më 13 mars 2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. URDHËROHET Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës në Prishtinë – Llogaria e vetme e Thesarit, që në emër të detyrimit të përcaktuar me Aktvendimin e kësaj gjykate, 2021:264423 të datës 30.03.2023, për lejimin e përmbarimit të dokumentit të ekzekutueshëm - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, C.nr.1886/21, të datës 13.12.2022, për shkak të kompensimit e ushqimit në punë si dhe të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, dhe atë:

- kreditores M.U., nga Gjakova, t’ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 352.00 euro, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe përmbarimore në shumën prej 378.00 euro,

përkatësisht shumën e përgjithshme prej 730.00 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh, në atë mënyrë që nga xhirollogaria e debitores së përbarimit, Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të barten këto mjetet monetare, në llogarinë e të autorizuarit së kreditores avokat Arben Biblekaj, në xhirollogarinë e tij bankare, me Nr....., në Bankën Kombëtare Tregtare-BKT.

II. OBLIGOHET pala kreditore dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Llogaria e vetme e Thesarit në Prishtinë, që gjykatën ta njoftoj me shkrim për zbatimin e këtij aktvendimi ose për arsyet e mos zbatimit të tij.

### A r s y e t i m

Gjykata duke vepruar sipas propozimit të kreditores së përbarimit, me aktvendimin 2021:264423, të datës 30.03.2023, ka lejuar përbarimin ndaj debitores Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit. Ndaj këtij aktvendimi, debitorja ka ushtruar prapësim me datë 19.04.2023, ndërsa i autorizuari i kreditoreve me datë 24.04.2023 ka paraqitur përgjigje në prapsim. Duke vendosur lidhur me prapësimin e debitores, gjykata me aktvendim 2021:264423, të datës 02.11.2023 ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e lartcekur.

Meqenëse pala kreditore në propozimin e saj për përbarim, ka cekur mjetin e përbarimit - transferimin e mjeteve monetare përmes xhirollogarive bankare e me qëllim të realizimit të detyrimit të lartë cekur në të holla, dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, kjo gjykatë gjeti se në rastin konkret, duhet të bëhet debitimi i mjeteve të lartcekura monetare, përkatësisht t'ia paguaj kreditores M.U., nga Gjakova, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 352.00 euro, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe përbarimore në shumën prej 378.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 730.00 euro, dhe atë për këto arsye:

Nga shikimi i shkresave të lëndës, 2021:264423, kjo gjykatë ka gjetur se në rastin konkret pjesë e detyrimit që rrjedh nga dokumenti i përbarimit – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, C.nr.1886/21, të datës 13.12.2022, i plotfuqishëm me datë 29.12.2022, dhe i ekzekutueshëm me datë 11.01.2023, për shkak të detyrimit në të holla, duke u bazuar në dokumentin e lartcekur të përbarimit, si dhe nenin 152 të LPP-së, debitorja, është e obliguar që kreditoreve të përbarimit, t'ia paguaj shumat e lartcekura të gjitha në afat prej 7 ditësh, andaj në arsyet e cekura më lart kjo gjykatë, vendosi që ta urdhëroj Ministrinë e Financave, Punës dhe

Transfereve në Prishtinë - Llogarinë e Thesarit, që të bëjë debitimin e mjeteve monetare si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të lartcekurat, gjykata duke u bazuar në nenet 3, 5 par.6 pika 2, 109 par.3, 113 dhe nenin 152 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**

- Departamenti i Përgjithshëm-

2021:264423, më 13 mars 2024

**GJYQTARI,**

**Durim BALAJ**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesë e veçantë.